



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 21518 Prot.

Lezhë, më 28 . 12 .2021

VENDIM

Nr. 181 Datë 23 . 12 .2021

PËR MIRATIMIN E SISTEMIT TË PIKËZIMIT PËR PROGRAMET SOCIALE TË STREHIMIT

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, ligjit nr 22/2018 “Për Strehimin Social”, neni 15 pika 3, VKM nr.362 datë 29.05.2019 “Për kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit, dhe mënyrën e llogaritjes së tij” pika 2 dhe 2.1, VKM nr. 384 datë 12.06.2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore” pasi shqyrtoi materialin e paraqitur nga Drejtoria e Sherbimit dhe Kujdesit Social, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë:

VENDOSI:

- I. Të miratojë sistemin e pikëzimit për programin social të strehimit si më poshtë:
 1. Sistemi i pikëzimit për trajtimin sipas programit të Subvencionimit të Qirasë sipas aneksit nr.1 bashkëngjitur.
- II. Të miratojë mënyrën e vlerësimit dhe llogaritjes sipas aneksit nr. 3
- III. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë
- IV. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes

SEKRETARI

FLORIDA ÇUNAJ

KRYETARI

ERNEST RAKAJ





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Aneksi nr. 1 - SISTEMI I PIKËZIMIT PËR TRAJTIMIN SIPAS PROGRAMIT TË
SUBVENCIONIMIT TË QIRASË

	KRITERET E PIKËZIMIT	Pikët
1.1	KUSHTET E STREHIMIT	30
A	Nuk disponon banesë në pronësi	10
B	Banojnë në banesa në rrezik shembje	8
C	Banojnë në banesa të mbipopulluara, sipas përcaktimeve dhe normave në fuqi.	5
Ç	Kanë ngelur ose rrezikojnë të ngelen të pastreha, si rezultat i fatkeqësive natyrore, ose zbatimit të një vendimi gjyqësor, janë përjashtuar nga legalizimi	7
1.2	KUSHTET FAMILJARE	20
A	Familje një prindërore që kanë në ngarkim fëmijë	7
B	Te moshuar që kanë mbushur moshën e pensionit dhe nuk janë perzgjedhur për tu strehuar në një institucion publik i perkujdesit shoqëror	5
C	Familjet me më shumë se katër fëmijë	6
Ç	Familje të reja ku çifti bashkëshortëve ka moshe të përbashkët totale deri 60 vjeç.	2
1.3	KUSHTET SOCIALE	20
A	Persona me aftësi të kufizuar/ Ndihe Ekonomike/invalidet e punës	6
B	Persona me statusin e jetimit që nga çasti i daljes nga qendrat e perkujdesit shoqëror e deri në moshën 30 vjeç/te miturit 14-18 vjeç dhe të rinjtë 18-21 vjeç në konflikt me ligjin	2
C	Emigrant i rikthyer/ Punëtor Emigrant/ Azilkerkues	2
Ç	Familjet e policëve të rënë në detyrë/FNSH/RENEA/PMNZSH	2
D	Viktima të dhunës në familje/trafikimit/e mundshme të trafikimit	6
E	Minoriteti Rom dhe Egjiptian	2
1.4	KUSHTET EKONOMIKE	30
A	Familje pa të ardhura	15
B	Familje me të ardhura shumë të ulëta, nën 70% të ardhurave mesatare	10
C	Familje me të ardhura të ulëta, midis 70% -100% të ardhurave mesatare	5
D	Familje me të ardhura mesatare midis 100%-120% të ardhurave mesatare	0



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Aneksi nr.3 - MENYRA E VLERËSIMIT DHE LLOGARITJA:

Në llogaritjen e pikëve për individët/familjet aplikuese, Komisioni i Strehimit duhet të marrë në konsideratë rregullat e mëposhtme:

I. Pikët maksimale që mund të përfitojë një individ/familje janë 100. Nuk mund të mbliidhen brenda për brenda një kriteri pikët:

1. Nga A deri në D të kriterit 1.1 - Kushtet e strehimit;
2. Nga A deri në Ç të kriterit 1.2 - Kushtet familjare;
3. Nga A deri në D të kriterit 1.4 - Kushtet ekonomike.

II. Pikët nga A deri në E të kriterit 1.3 mund të mbliidhen me njëra-tjetrën sipas rasteve më poshtë:

1. Pika A mund të mbliidhet me njërin prej rasteve si më poshtë:
 - a) Me pikat B dhe Ç së bashku ose veçmas;
 - b) Vetëm me pikën C;
 - c) Vetëm më pikën D.
 - d) Vetem me piken E
2. Pika B mund të mbliidhet vetëm me pikën A.
3. Pika C mund të mbliidhet vetëm me pikën A.
4. Pika Ç mund të mbliidhet me pikat A e B së bashku ose me njërën prej tyre. Në total mbledhja e pikëve A, B e Ç nuk duhet të rezultojë më e lartë se 20 pikë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË

Lezhë, me 15/12/2021

RELACION
PËR P/VENDIMIN

PËR MIRATIMIN E SISTEMIT TË PIKËZIMIT PËR PROGRAMET SOCIALE TË
STREHIMIT

Miratimi i sistemit të pikëzimit është një detyrim ligjor pas hyrjes në fuqi të ligjit “Për Strehimin Social” në fund të vitit 2018 për të gjitha njesitë e qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë.

Në nenin 15 pika 3 e ligjit nr.22/2018 “Për Strehimin Social” parashikon se Njësiti e Vetëqeverisjes Vendore hartojnë, miratojnë dhe publikojnë sistemin e pikëzimit çdo vit, të specifikuar për çdo njësi të vetëqeverisjes vendore dhe për çdo program që zbatohet, duke u bazuar në kriteret e përcaktuara në këtë ligj.

Gjithashtu në nenin 15, pika 1, e ligjit 22/2018, parashikon se përzgjedhja e subjekteve dhe familjeve përfituese bëhet nëpërmjet një sistemi pikëzimi, i cili miratohet dhe publikohet për çdo program nga njësia e vetëqeverisjes vendore, bazuar në parimet e parashikuara në këtë ligj, si dhe kriteret e bëra publike përpara fillimit të procesit të aplikimit.

Për programin e subvencionimit të qirasë me qëllim që përfituesit të jenë shtresat me pak të favorizuara dhe në gjendje të veshtirë ekonomike, propozuam një sistem pikëzimi që përparësi të kenë familjet të cilat kanë në përbërje familjare persona me aftësi të kufizuar, familje që trajtohen ndihmë ekonomike, minoritet Rom dhe Egjiptian, viktimat e dhunës në familje, familjet pa të ardhura, etj.

**Aneksi nr. 1 - SISTEMI I PIKËZIMIT PËR TRAJTIMIN SIPAS PROGRAMIT TË
SUBVENCIONIMIT TË QIRASË**

	KRITERET E PIKËZIMIT	Pikët
1.1	KUSHTET E STREHIMIT	30
A	Nuk disponon banesë në pronësi	10
B	Banojnë në banesa në rrezik shembje	8
C	Banojnë në banesa të mbipopulluara, sipas përcaktimeve dhe normave në fuqi.	5
Ç	Kanë ngelur ose rrezikojnë të ngelen të pastreha, si rezultat i fatkeqësive natyrore, ose zbatimit të një vendimi gjyqësor, janë përjashtuar nga legalizimi	7
1.2	KUSHTET FAMILJARE	20
A	Familje një prindërore që kanë në ngarkim fëmijë	7



B	Te moshuar qe kane mbushur moshen pensionit dhe nuk jane perzgjedhur per tu strehuar ne nje institucion publik perkujdesit shogeror	5
C	Familjet me më shumë se kater fëmijë	6
Ç	Familje te reja ku çifti bashkëshortëve ka moshe te perbashket totale deri 60 vjeç.	2
1.3	KUSHTET SOCIALE	20
A	Persona me Aftësi të Kufizuar/ Ndhme Ekonomike/invalidet e punes	6
B	Persona me statusin e jetimit që nga çasti i daljes nga qendrat e përkujdesit shoqëror e deri në moshën 30 vjeç/te miturit 14-18 vjeç dhe të rinjte 18-21 vjeç në konflikt me ligjin	2
C	Emigrant i Rikthyer/ Punëtor Emigrant/ Azilkerkues	2
Ç	Familjet e policëve të rënë në detyrë/FNSH/RENEA/PMNZSH	2
D	Viktima të dhunës në familje/trafikimit/e mundshme të trafikimit	6
E	Minoriteti Rom dhe Egjipian	2
1.4	KUSHTET EKONOMIKE	30
A	Familje pa te ardhura	15
B	Familje me të ardhura shumë të ulëta, nën 70% të ardhurave mesatare	10
C	Familje me të ardhura të ulëta, midis 70% -100% të ardhurave mesatare	5
D	Familje me të ardhura mesatare midis 100%-120% të ardhurave mesatare	0

Ky sistem pikëzimi, do të jetë baze për përzgjedhjen e subjekteve dhe familjeve përfituese nga Komisioni i Strehimit për hartimin e listave të përfituesve nga programi i Subvencionimit të qirasë për vitin 2022.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË

Aneksi nr.3 - MENYRA E VLERËSIMIT DHE LLOGARITJA:

Në llogaritjen e pikëve për individët/familjet aplikuese, Komisioni i Strehimit duhet të marrë në konsideratë rregullat e mëposhtme:

III. Pikët maksimale që mund të përfitojë një individ/familje janë 100. Nuk mund të mblidhen brenda për brenda një kriteri pikët:

1. Nga A deri në D të kriterit 1.1 - Kushtet e strehimit;
2. Nga A deri në Ç të kriterit 1.2 - Kushtet familjare;
3. Nga A deri në D të kriterit 1.4 - Kushtet ekonomike.

IV. Pikët nga A deri në E të kriterit 1.3 mund të mblidhen me njëra-tjetrën sipas rasteve më poshtë:

1. Pika A mund të mblidhet me njërin prej rasteve si më poshtë:
 - e) Me pikat B dhe Ç së bashku ose veçmas;
 - f) Vetëm me pikën C;
 - g) Vetëm me pikën D.
 - h) Vetëm me pikën E
2. Pika B mund të mblidhet vetëm me pikën A.
3. Pika C mund të mblidhet vetëm me pikën A.
4. Pika Ç mund të mblidhet me pikat A e B së bashku ose me njërin prej tyre. Në total mbledhja e pikëve A, B e Ç nuk duhet të rezultojë më e lartë se 20 pikë.

Procedura që ndiqet për subvencionimet e qirave *(neni 9 pika a shkronja iv ligjit 22/2018)*

Aplikimi për të përfituar strehim me perjashtim të rasteve të nevojës emergjente bëhet sipas kriterëve të mëposhtme:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LEZHË

Plotësimi i formularit për aplikimin pranë Bashkisë Lezhë. Aplikantët paraqesin kërkesën e tyre për të përfituar nga programet e strehimit social sipas formatit të miratuar në shtojcën A të VKM 384/12.06.2019.

1. Brenda muajit nëntor të çdo viti rishikohen nga njësitë e vetëqeverisjes vendore aplikimet dhe dokumentacioni i nevojshëm, i përditësuar, për risubvencionim për vitin pasardhës nga përfituesit ekzistues dhe i përcillen ministrisë përgjegjëse për strehimin *(neni 35 pika 1 e ligjit 22/2018)*
2. Kërkesat e aplikuesve të rinj, për përfitimin e subvencionimit, mund të paraqiten në çdo kohë gjatë vitit, por jo më vonë se muaji nëntor për vitin pasardhës *(neni 35 pika 2 e ligjit 22/2018)*
3. Hartimi i listës së përfituesve kryhet nga grupi i punës i ngritur nga Kryetari i Bashkisë *(neni 15 pika 5 e ligjit 22/2018)* i cili shqyrton aplikimet dhe përzgjedh aplikantët në bazë të sistemit të pikëzimit të miratuar nga Këshilli i Bashkisë *(neni 15 pika 1 e ligjit 22/2018)*
4. Komisioni i Strehimit vlerëson listën e përfituesve dhe dokumentacionin perkates *(neni 15, pika 5 - ligjit 22/2018)*
5. Brenda një **muaji** nga data e miratimit të listës së përfituesve nga Komisioni i Strehimit subjekti përfitues depoziton kontratën e qirase *(neni 39 pika 1 e ligjit 22/2018)* dhe plotësimin e dokumentacionit ligjor që verteton sipas deklaramit në formularin e kërkesës *(neni 12 pika c - vkm 384/12.06.2019)*
6. Pas depozitimit të kontratave të qirave të subjekteve përfituese, komisioni i strehimit i përcjell këshillit të njësisë së vetëqeverisjes vendore listën dhe kontratat e qirasë, me qëllim që ai të vendosë miratimin e vlerave konkrete të subvencionit të qirasë për çdo përfitues *(neni 39 pika 3 e ligjit 22/2018)* Struktura përgjegjëse për strehimin brenda 3 ditëve pas hartimit të listës përfundimtare dërgon për miratim në Këshillin e Bashkisë i cili merr vendim në mbledhjen e rradhës *(neni 18, vkm 384/12.06.2019)*.
7. Mbledhja e këshillit të njësisë së vetëqeverisjes vendore zhvillohet jo më vonë se një muaj nga data kur mbërrijnë listat e miratuara nga komisioni i strehimit *(neni 39 pika 3 e ligjit 22/2018)*.
8. Pas miratimit të listës përfundimtare nga Këshilli Bashkiak, ajo do të bëhet publike në faqen e internetit të Bashkisë Lezhë *(neni 9 pika b ligjit 22/2018)*.
9. Kundër Vendimit të Këshillit Bashkiak për “Miratimin e listës së përfituesve për Subvencionimin e Qirasë” mund të bëhet ankimi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë brenda 10 ditëve nga hyrja në fuqi. *(neni 9 pika a shkronja v ligjit 22/2018)*.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË


Formulari i Aplikimit së bashku me dokumentacionin e kërkuar duhet të dorëzohen në kopje origjinale personalisht pranë zyres së strehimit në Bashkinë Lezhë.


KOMISIONI I STREHIMIT

1. Eneda Molla 

2. Mark Fletaj 

3. Senië Ferok 

4. Kurban Laci 

5. Bukena Dugan 

6. _____

7. Zef Ueshi 